

NJOFTIM

Drejtuar : Agjencise Kombetare te Mjedisit

Lenda: Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria "A&T" Sh.a njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A per instalimin "Industritë energjitike", ID 1.9. Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj: a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisterna te palevizshme ne ndonje terminal, ose ngarkimi/shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne/nga nje cisterne e levizshme, cisterne hekurudhore ose anije e ujerave te brendshme ne terminal. b. Shkarkimi naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisternat e stacioneve te furnizimit me karburant.", Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Te gjitha instalimet me vendndodhje në F. I. E. T. K, Narte – Vlore, Zona Kadastrale 8605, Numer Pasurie 6/175, Vlore, depozite me numer RMV-1.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 , Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", kreu VI "Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B", bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B".
- b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
- f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
- g) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjisllacionit në fuqi;
- h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise

"A&T" Sh.a

Fabian Goçi

- a. Kërkesa për vendosjen në funksionim të instalimit “Depozites së naftës dhe nënprodukteve të saj” është për aplikim **per leje të re mjedisore të tipi A**, sipas Shtojcës 1, të Ligjit Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”, “Industritë energjitike”, ID 1.9. Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj: a. Magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternë të palevizshme në ndonjë terminal, ose ngarkimi/shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në/nga një cisternë e levizshme, cisternë hekurudhore ose anije e ujerave të brendshme në terminal. b. Shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant.”, Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Të gjitha instalimet me kapacitete 5 000 m³.
- b. **TE DHËNAT E EKSTRAKTIT TË QKB-SE**




**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L32320008H			
2. Data e Regjistrimit	20/11/2013			
3. Emri i Subjektit	A&T			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	14/11/2013			
6. Kohëzgjatja	Nga: 14/11/2013 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tiranë Tiranë TIRANË Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga "Ibrahim Rugova", Kulla "Sky Tower", Kati 7, Apartamenti Nr.3			
8. Kapitali	3.500.000,00			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	875000.0000			
10. Numri i aksioneve:	1.000,00			
10.1 Vlera nominale:	3.500,00			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejtë vote	pa të drejtë vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Hidrokarbure, naftë dhe gaz I Import-eksport i karburanteve dhe derivateve të tyre të tilla si naftë, benzine, karburantet e aviacionit, vajra, lubrifikante, solar, etj; Tregtim me shumicë dhe pakicë të karburanteve dhe derivateve të tyre të tilla si naftë, benzine, vajra, lubrifikante, solar, etj; Transport i karburanteve dhe derivateve të tyre të tilla si naftë, benzine, vajra, lubrifikante, solar, etj Import - eksport i gazit të lëngshëm (LPG) për automjete, përdorim familjar, dhe konsumator; Shitje, tregtim i gazit të lëngshëm (LPG) për automjete, përdorim familjar, dhe konsumator; Import - eksport i			

	<p>bombolave të gazit; Shitje, tregtim dhe rimbushje të bombolave me gaz; Import - eksport të produkteve për kujdesin e automjeteve; Shitje dhe tregtim të produkteve për kujdesin e automjeteve; Import-eksport i hidrokarbureve; Shitje, tregtim dhe transport i hidrokarbureve përfshirë LPG në masë dhe shishe; Tregtim i veshjeve dhe produkteve që lidhen me industrinë e naftës; Miniera Eksplorim, zhvillim, pasurim, trajtim, transportim dhe tregtim të mineraleve; i Shfrytëzimit i të gjitha llojeve të mineraleve; Import - Eksport i të gjitha llojeve të mineraleve; Import - Export i makinerive dhe pajisjeve të lidhura me to; Energjia e përditshme (rinovueshme) Projektim, ndërtim, menaxhim i hidrocentraleve , kaskadave, impianteve të energjisë së erës dhe impianteve të energjisë diellore; Menaxhimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve, kaskadave, impianteve të energjisë së erës dhe impianteve të energjisë diellore; Import - eksport, shpërndarje, tregtim dhe shitje të energjisë së erës, të energjisë diellore, të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe çdo energji tjetër të rinovueshme si dhe nënproduktet të tjera të burimeve të energjisë së rinovueshme, importim dhe eksportim i mjeteve motorike dhe përfaqësimin e furnizuesit dhe prodhuesit; Distribucion i Autorizuar i Shoqërive të luaja në sektore si ushqimi, pijet, veshmbathjet, urretë kompjuterike, etj; Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihen objektivat e mesipërme, kompania mund të: Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo ato të paluajtshme si dhe çdo aktivitet tregtar, të vendosë pengje ose barre hipotekore, aktivitete këto të konsideruara të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë. Për më tepër Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi, që sjell përfitime dhe është në interes të Shoqërisë. Shoqëria zbaton dhe respekton të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo zbaton standardet me të larta të etikës.</p>		
13. Sistemi i administrimit	<input type="checkbox"/> me një nivel <input checked="" type="checkbox"/> me dy nivele		
14. Administratori/ët	Fabian Goçi		
14.1 Afati i emërimit	<table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%;">Nga : 18/12/2014</td> <td style="width: 50%;">Deri : 18/12/2017</td> </tr> </table>	Nga : 18/12/2014	Deri : 18/12/2017
Nga : 18/12/2014	Deri : 18/12/2017		
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.			
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).			
16. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Gjergji Kondi		
16.1 Kryetar/anëtar	Anëtar		
16.2 Afati i emërimit	<table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%;">Nga : 20/12/2016</td> <td style="width: 50%;">Deri : 20/12/2019</td> </tr> </table>	Nga : 20/12/2016	Deri : 20/12/2019
Nga : 20/12/2016	Deri : 20/12/2019		
17. Anëtar i Dëvatur	Po		
17.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Jo		


c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

Emri i instalimit/impianit ¹	Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj		
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	F. I. E. T. K, Narte – Vlore, Zona Kadastrale 8605, Numer Pasurie 6/175, Vlore, depozit RMV-1		
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Kordinatat e Depozitave te naftes dhe neprodukteve te saj		
	Zona 2		
	1	43 70 715.88	44 85 115.63
	2	43 70 816.21	44 85 181.87
	3	43 70 883.65	44 85 082.81
	4	43 70 787.81	44 85 012.86
	Depozita		
Depozit 7	43 70 804.69	44 85 067.86	
			
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi ²	Industriete energjitike 1.9		
Kapaciteti i projektuar	“Industriete energjitike, ID 1.9. Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj: a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisterna te palevizshme ne ndonje terminal, ose ngarkimi/shkarkimi i naftes dhe		

¹ Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

² Shkruani kodet e specifikuar në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

	<p>nenprodukteve te saj ne/nga nje cisterne e levizshme, cisterne hekurudhore ose anije e ujerave te brendshme ne terminal.</p> <p>b. Shkarkimi naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisternat e stacioneve te furnizimit me karburant.”, Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Te gjitha instalimet.</p> <p>Kapaciteti: 1 depozita me kapacitet stokues 5 000 m³</p>
--	---



A&T Sha
RMV-1

- SPERQUES**
- ① REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ② REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ③ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ④ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ⑤ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ⑥ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ⑦ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ⑧ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ⑨ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ⑩ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ⑪ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ⑫ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ⑬ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ⑭ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ⑮ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ⑯ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ⑰ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ⑱ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ⑲ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ⑳ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㉑ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㉒ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㉓ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㉔ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㉕ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㉖ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㉗ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㉘ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㉙ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㉚ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㉛ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㉜ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㉝ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㉞ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㉟ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㊱ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㊲ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㊳ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㊴ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㊵ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㊶ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㊷ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㊸ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㊹ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㊺ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㊻ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㊼ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㊽ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz
 - ㊾ REZERVUARIT 3000 l/sa benzol
 - ㊿ REZERVUARIT 3000 l/sa gaz

PARNUJ LIQERIZESH

① PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

② PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

③ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

④ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑤ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑥ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑦ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑧ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑨ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑩ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑪ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑫ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑬ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑭ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑮ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑯ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑰ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑱ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑲ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

⑳ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉑ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉒ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉓ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉔ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉕ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉖ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉗ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉘ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉙ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉚ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉛ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉜ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉝ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉞ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㉟ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊱ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊲ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊳ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊴ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊵ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊶ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊷ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊸ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊹ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊺ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊻ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊼ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊽ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊾ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

㊿ PARNUJ LIQERIZESH 1000 L/S

d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

AKTIVITETI: Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj
Adresa: Ne Parkun e Ri, FIETK-Vlore, Zona Kadastrale 8605, Numer Pasurie 6/175, Vlore, depozita RMV-1
Subjekti: "A&T" Sh.a
Administrator: Fabian Goçi

Celular 00355 68 205 0774

- **Hyrje**

Profili i shoqërisë "A&T" për shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe neprodukteve te saj.

Instalimi per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj të shoqërisë "A&T" është i pozicionuar ne F.I.E.T.K, Narte-Vlore, Zone Kadastrale 8605, Nr. Pasurie 6/175, Vlore, deposit RMV-1. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin ne fushen Hidrokarbure, naftë dhe gaz I Import-eksport i karburanteve dhe derivateve te tyre te tilla si naftë, benzine, karburantet e aviacionit, vajra, lubrifikante, solar, etj; Tregtim me shumice dhe pakice te karburanteve dhe derivateve te tyre te tilla si naftë, benzine, vajra, lubrifikante, solar, etj; Transport i karburanteve dhe derivateve te tyre te tilla si naftë, benzine, vajra, lubrifikante, solar, etj Import - eksport i gazit te lengshem (LPG) per automjete, perdorim familjar, dhe konsumator; Shitje, tregtim i gazit te lengshem (LPG) per automjete, perdorim familjar, dhe konsumator; Import - eksport i bombolave te gazit;Shitje, tregtim dhe rimbushje te bombolave me gaz; Import - eksport te produkteve per kujdesin e automjeteve; Shitje dhe tregtim te produkteve per kujdesin e automjeteve; Import-eksport i hidrokarbureve; Shitje, tregtim dhe transport i hidrokarbureve perfshire LPG ne mase dhe shishe; Tregtim i veshjeve dhe produkteve qe lidhen me industrine e naftes; Miniera Eksplorim, zhvillim, pasurim, trajtim, transportim dhe tregtim te mineraleve; i Shfrytezim i te gjitha llojeve te mineraleve; Import - Eksport i te gjitha llojeve te mineraleve; Import - Export i makinerive dhe pajisjeve te lidhura me to; Energjia e perteritshme (rinovueshme) Projektim, ndertim, menaxhim i hidrocentraleve , kaskadave, impianteve te energjise se eres dhe impianteve te energjise diellore; Menaxhimi dhe mirembajtja e hidrocentraleve, kaskadave, impianteve te energjise se eres dhe impianteve te energjise diellore; Import - eksport, shperndarje, tregtim dhe shitje te energjise se eres, te energjise diellore, te energjise elektrike nga hidrocentralet dhe cdo energjie tjeter te rinovueshme si dhe nenproduktet te tjera te burimeve te energjise se rinovueshme, importim dhe eksportim i mjeteve motorrike dhe perfaqesimin e furnizuesit dhe prodhuesit; Distribucion i Autorizuar i Shoqerive te huaja ne sektore si ushqimi, pijet, veshmbathjet, njesite kompjuterike, etj.; Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihen objektivat e mesiperme, kompania mund te: Te kryeje cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme apo ato te paluajtshme si dhe cdo aktivitet tregtar, te vendose pengje ose barre hipotekore, aktivite keto te konsideruara te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise. Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfrtime dhe eshte ne interes te Shoqerise. Shoqeria zbaton dhe respekton te gjitha ligjet dhe rregulloret perkatese. Ajo zbaton standardet me te larta te etikes, me NR NIPT: **L32320008H**. Sheshtet ku jane ndertuar depozitat e

magazinimit te karburantit jane me bazament te qendrueshem dhe respekton te gjitha kondicionet urbanistike. Keto objekte jane ndertuar konform legjislacionit shqiptar per urbanistiken duke respektuar distancat nga kufiri i pronesise. Objektet e depozitave ndodhen ne Filialin e Import Eksportit dhe Tregtimit te Karburanteve i cili gjenet ne hyrje te qytetit te Vlores, pergjate lagunes se Nartes, me orientim nga pjesa perendimore e ketij qyteti.

- Siperfaqe totale qera depozita me numer RMV-1
- Kapaciteti i stokut te depozites 5 000 m³

Filiali i Import Eksportit dhe Tregtimit te Karburanteve shtrihet ne krahun e djathte te rruges nacionale Fier – Vlore dhe kufizohet:

- Nga Veriu	K.U.B + Ullishte
- Nga Lindja	K.U.B + Shesh i lire
- Nga Jugu	Shesh i lire + Rruge e lire
- Nga Perendimi	K.U.B + rruga e Nartes

Shoqeria A&T Sh.a ka nenshkruar kontraten e nen-qirase me date 19.01.2017 me shoqerine “IONIAN REFINING AND TRADING COMPANY” Sh.a me Nr. 145 Rep, Nr. 53 Kol per marrjen me era te depozites me kapacitet stokues 5 000 m³, me numer RMV-1 5000 m³ me vendndodhje ne Parkun e Vjeter FIETK-Vlore, Zona Kadastrale 8605, Numer Pasurie 6/175.

- **F.I.E.T.K Vlore perbehet nga dy parqe**

- I- **Parku i Vjeter**

Parku i vjeter eshte ndertuar ne vitin 1957, si stacion i grumbullimit te naftes bruto (ndermjetes) i lidhur me stacionin e naftes Skrofotine, stacionin e Peshkepise dhe ate te ujit te ftohte. Ka ne perberje te tij 3 rezervuar me kapacitet stokues 5 000 m³ secili.

Ne kete stacion dhe ne ate te tregtimit te karburanteve eshte ruajtur dhe manipuluar nafte bruto nga vendburimet e Gorishit, Patosit dhe Ballshit, si dhe neprodukte te naftes si gasoil, virxhin nafte, vajguri, etj.

Deri ne vitin 1974, si terminal eksporti, per naften bruto eshte perdorur stacioni i ujit te ftohte, ne te cilin kane funksionuar 3 rezervuare te nendheshem b/a, te ciltet jane ndertuar ne vitin 1930.

Aktualisht lidhja me ta eshte bere e pamundur, per shkak te vendodhjes se tyre brenda zones se banuar dhe turistike.

Ne vitin 1979 perfundoi ndertimi i parkut te ri te stacionit Narte, te cilit iu shtuan edhe 4 rezervuare me nje kapacitet prej 5 000 m³ secili.

Ne F.I.E.T.K Vlore jane 7 rezervuare me kapacitet 5 000 m³ secili, ku shoqeria A&T Sh,a ka marre me nen-qira vetem 1 depozite RMV-1.

Kapaciteti total, stokues i depozites ne terminalin Narte – Vlore, eshte 5 000 m³.

Ne distance 3.7 km nga bregu i detit, ne koordinata 19° 24' 28" eshte ndertuar nje sistem ancorimi per tankera transporti hidrokarburesh, i cili eshte kompletuar me nje piacal me pilota, te ngulura ne tabanin e detit, te ndritura nga niveli i detit 4 m, me nje shesh betoni 6x6x0.6 ne afersi te te cilit eshte vendosur nje sistem bovash te lidhura ne 5 korpomorto te kompletuara secila me gadina d=80-100 mm dhe gjatesi 75 m secila.

Korpomortot jane te tipit prizmatik me peshe 90 ton dhe me vellim 37 m³. Shamoduret jane te tipit MNA-200, me gjatesi 25 ml. Gadinat jane me diameter 18 mm.

Stacioni i Nartes ne vetvete eshte kompletuar me dy parqe rezervuaresh te lidhur midis tyre me ane te tubacioneve teknologjike, qe bejne furnizim me dalje prej tyre te lendeve hidrokarbure dhe ujit teknologjik.

Gjendja teknike e rezervuareve eshte relativisht e mire. Parku i vjeter eshte rikonstruktuar ne vitin 1994 – 1996 dhe eshte ruajtur gjendja me tre rezervuar 5000 m³ secili, si dhe argjinature me mur guri te lidhura me nje sistem kunetash betoni qe perfundojne ne nje separator me kapacitet mbajtes 150 m³.

Parku i ri eshte kompletuar me argjinature me mur guri dhe sistem kullimi e drenazhimi, si dhe me pusetat dhe kllapushkat respective qe perfundojne ne nje sistem mbledhes te kompletuar me pompa centrifugale.

Te dy parqet jane te lidhur me sistem shuarje zjarri me impiante stacionare, te cilat jane te kompletuar me motor V2-300 pompe centrifugale dhe motor elektrik.

• **Nenproduktet e naftes qe trajton dhe manipulon ky filial kane keto karakteristika**

Nr.	Emertimi i analizes	Nj.	G/vendi	G/imp	V/Nafta
1	densiteti ne 15oC	Gr/cm3	0.848	0.841	0.743
2	Fillimi i vlimit	oC	175	190	59
3	% vol. deri ne 250 oC	ml	46	38	10%-90oC
4	% vol. deri ne 350 oC	ml	96	96	50%-115oC
5	Mbarimi i vlimit	oC	370	370	Max. 200 oC
6	Aciditeti total mgKOH/100gr produkt	gr	0.03	0.03	0.03
7	Viskoziteti Kinematik 40 oC	cst	2.7	2.7	-
8	Koksi	%	0.05	0.05	-
9	Hiri	%	0.006	0.006	-
10	Permbajtja e sqfurit	%	0.21	0.21	0.08 ppm
11	Temperatura e flakerimit	oC	72	72	-
12	Permbajtja e ujit	%	mungon	mungon	mungon
13	Mbeturinat mekanike	%	mungon	mungon	mungon
14	Prova e places se bakrit		reziston	reziston	reziston

15	Temperatura e ngrirjes	oC	-10	<-10	-
16	Rreshira faktike	mg	-	-	Nuk lejohen

- Gazoili i prodhuar ne vend, gazoili i importuar, si dhe nafta virgin per cdo furnizim, ervec dokumentacionit financiar shoqerohet dhe me certifikat analize, ne te cilat dokumentohen vetite fiziko-kimike.
- Per cdo furnizim merren kampione dhe dergohen rane Inspektoriatit Shteteror Teknik Industrial ISHTI ne Tirane, per te verifikuar cilesine e hidrokarbureve qe tregetohen. Verifikimi i parametrave behet nepermjet klasifikimit te tyre me standartin shteteror.

Teknologjia e shfrytezimit dhe ruajtjes se nenprodukteve te nates, teknikisht kerkon pastrimin e rezervuareve nga mbetjet mekanike, asfalteno-rreshinore, parafinike, te ciltat sipas intensitetit te mbushje-zbrazjes se rezervuareve behet rregullisht njehere ne 5 vjet. Te gjitha keto mbetje qe dalin, pervec hidrokarbureve, ne gjendje te lenget, te cilet grumbullohen ne separatoret ndares dhe riciklohen perseri, grumbullohen ne vende te caktuara dhe nuk perbejne problem per ndotje te mjedisit.

Catite e rezervuareve jane te kompletuara me valvula frymemarrje, me flanaxha hermetizuese, bakaporta matjeje, flakeshuarese, xhama te dhomave te shkumes, etj.

Qellimi

Qellimi kryesore i filialit te import-eksportit dhe tregtimit te karburanteve Vlore eshte manipulimi i te gjithe hidrokarbureve qe depozitohen ne rezervaret ekzistues te ketij filiali, eksportimi dhe importimi i tyre, ne perputhje me kontratat, apo akt-marrveshjet e lidhura midis paleve kontraktuese.

- **Pershkrimi i pajisjeve dhe proceseve te punes**

Karburantet vijne ne rrugu tokesore me autocisterne, ne ate detare me anije te tipit cisterne. Ruajtjen e tyre ne rezervaret perkates, mbushjen e autoscisternave, si dhe shperndarjen e tyre ne destinacionin e ruajne shoqerite perkatese, Eshte projektuar stacioni i mbushjes se autocisternave, duke perfshire ne perputhje me sasine e produkteve te naftes dhe neprodukteve te saj, kapacitetin e stacionit te furnizimit. Mbushja e rezervuareve me produktet respective realizohet nepermjet stacionit te pompimit me pompa centrifugale.

Gjithashtu duke patur parasysh dhe mundesine e pashmangshme te lindjes se rrymave elektrostатike gjate levizjes se lengut (produktit te naftes dhe nenprodukteve te saj) neper tubacione, rezervuare, etj, gjate proceseve te ngarkimit e shkarkimit, dukuri kjo e rrezikshme per lindjen e vatrave te zjarrit, ne projekt jane marre masa per evitimin e pasojave. Mbrojtja nga rryma elektrostатike te tubacioneve te linjave teknologjike te projektuara, realizohet permes lidhjeve te konstruksioneve metalike te tyre, tek paisjet e sistemit te tokezimit. Rezistenca e kalimit te rrymes jo me shume se 100 ohm.

Ne kuadrin e mbrojtjes se objekti nga mundesia e lindjes se zjarrit, eshte parashikuar edhe mbrojtja e tij nga shkarkimet atmosferike. Te gjitha objektet, si rezervuare cilindrike vertikale mbitoksore dhe ato me lartesi te madhe te ndodhura brenda territorit te sheshit te objektit te rezervuareve, si shtyllat e

ndricimit me prozhektore, shtyllat e flamujve dhe ato te furnzimit me energji elektrike perfshihen ne sistemin e mbrojtjes, nga renia nen tension. Mbrojtja e rezervuareve realizohet me instalime te elektrodave te tokezimit te lidhura direkte me trupin e tyre, Stacioni i mbushjes se autocisternave per mbrojtje realizohet me tokezimin e konstruksionit metalik te tendes se mbulimit, Objekte te tjere, nyjet teknologjike te grup saracineskash, shtyllat e prozhektoreve, etj tokezohen duke u lidhur ne sistemin e mbrojtjes te nenobjekteve ne vecanti ose te objektit ne teresi.

1. Rezervuare 5000 m³ (Sip = 8000 m²)
2. Rezervuari i shkumes (Sip= 12.3 m²)
3. Separatori (Sip=33.75m²)
4. Rezeruari i shkumes (Sip- 12.3 m²)
5. Mure mbrojtjes (Argjinatura Sip=620.6 m²)
6. Rruget e brendshme (Sip=4770m²)
7. Impianti i MNZ (Sip= 44 m²)
8. Rezervuar uit 600 m³ (Sip= 188.7 m²)
9. Tetoja e saldimit (Sip= 18.8 m²)
10. Depo e bombulave te oksigjenit (Sip=5.2 m²)
11. Salla e pompave te MNZ (Sip=86.6 m²)
12. Rezervuar shkume (Sip=15 m²)
13. Rezervuar uji 600 m³ (Sip= 188.7 m²)
14. Salla e pompave (Sip= 67.9 m²)
15. Reparti mekanik – oficina (Sip= 80.1 m²)
16. Salla e pompave (Sip=224.03 m²)
17. Vaske saracineske (Sip=58.5 m²)
18. Zyrat e sektorit (Sip=90.24 m²)
19. Tualet WC (Sip=8.4 m²)
20. Separatori (Sip=64.5 m²)
21. Depo (Sip=7.04 m²)
22. Mur mbrojtjes – argjinatura (Sip=429.2 m²)
23. Bazament rezervuari (Sip=707 m²)
24. Rezervuar 5000 m³ (Sip= 11 589.5 m²)
25. Ndricues (Sip=1.5 m²)

26. Kulle vrojtimi (Sip= 4 m2)
27. Post- Blloku (Sip=5.5 m2)
28. Gardh teli
29. Mur rrethues me blloqe (Sip= 55.5 m2)
30. Estakada Import – Eksporti (Sip=21.3 m2)
31. Kendi i MNZ (Sip= 42.9 m2)
32. Estakada e sektorit te tregtise (Sip=39.7 m2)
33. Kendi i MNZ (Sip=42.9 m2)
34. Zyrrat e filjalit (Sip = 246.3 m2)
35. Rezervuaret e solarit (Sip= 274.2 m2)
36. Rezervuar 100 m3 (Sip= 336 m2)
37. Rezervuar 100 m3 (Sip= 336 m2)
38. Rezervuar 100 m3 (Sip= 336 m2)
39. Rezervuar 100 m3 (Sip= 336 m2)
40. Njesia e tregtimit (Sip= 1010 m2)
41. Zyrrat e magazines (Sip= 20.48 m2)
42. Depo (Sip= 441 m2)
43. Mur rrethues (Sip= 314.3 m2)
44. Mur (Sip=46.9 m2)

Aktiviteti zhvillohet ne nje ambient te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth.

Vendosja e instalimeve per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe neprodukteve te saj ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj.

Duhet specifikuar fakti ze objekte jane ekzistuese te ndertura vite me pare.

Gjithashtu ne kete ambient bejne pjese edhe hapesirat per levizjen e mjeteve, njerezve dhe sipërfaqet e gjelbera, sheshet jane te rrethuar, sheshi cili eshte i gjelberuar anash me bimesine karakteristike te ketyre ambienteve.

Pamje nga proceset dhe impiantet e instaluar



Pamje te deponitave. Jug-Veri



Pamje te deponitave. Veri-Jug

- **Ndërtimi i linjës elektrike**

Në varësi të llojit të impiantit dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrethi i shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjendje mjaft të mirë dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Objekti dhe instalimet/pajisjet për shpërndarjen dhe magazinimin e naftës dhe neprodukteve të saj në të gjitha ambientet e tyre janë pajisur me kasete të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- **Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme**

Objekti lidhet me rrugën dytesore "Nikoll Xhuveli". Rruga e cila të dërgon në hyrje të objektit është ekzistuese dhe në gjendje mjaft të mirë e shtruar me cakull dhe e niveluar sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke mundësuar levizjen e lirë të mjeteve. Gjithashtu përgjatë gjithë gjatësisë së infrastrukturës së brendshme është ndërtuar edhe rrjeti i drenazhimeve të ujërave të shiut dhe ujërave teknologjike të cilat derdhen në separatorin e ndarjes.

Planvendosja e depozitave e paraqitur në ortofoto.



Planvendosja e impiantit sipas Gaus Kruger 1942 Zone 4



Kordinatat e Depozitave te naftes dhe neprodukteve te saj		
Zona 2		
1	43 70 715.88	44 85 115.63
2	43 70 816.21	44 85 181.87
3	43 70 883.65	44 85 082.81
4	43 70 787.81	44 85 012.86
Depozita RMV-1		
Depozit 7	43 70 804.69	44 85 067.86

Kondicionet urbanistike të objektit për depozitën e naftes dhe neprodukteve të saj, janë si më poshtë:

EMRI I TREGTAR	"A&T" Sh.a
SIPËRFAQJA ME NEN-QIRA	1 depozite me volum 5000 m ³
VEPRIMTARIA	Shpërndarja dhe magazinimi i naftes dhe neprodukteve të saj
STATUSI SHOQËRISË	AKTIV
VENDODHJA E AKTIVITETIT	Ne Parkun e Ri, FIETK-Vlore, Zona Kadastrale 8605, Numer Pasurie 6/175, Vlore, depozita numer RMV-1.

e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**

“Industriete energjitike, ID 1.9. Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj: a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisterna te palevizshme ne ndonje terminal, ose ngarkimi/shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne/nga nje cisterne e levizshme, cisterne hekurudhore ose anije e ujerave te brendshme ne terminal. b. Shkarkimi naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisternat e stacioneve te furnizimit me karburant.”, Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Te gjitha instalimet. (Kapaciteti 5 000 m³)

- **LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Lendet e para qe perdoren per funksionimin e instalimit jane:

- Naftë dhe nenproduktet e saj
- Pjese kembimi per instalimet
- Uje
- Hidrante
- Rere
- Shkume

- **BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI;**

Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	1
Burimi i shkarkimit	Depozitat e karburantit
Përshkrimi	Proceset e shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe neprodukteve te saj
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	X: 43 70 804.69 Y: 44 85 067.88
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	
Data e fillimit të shkarkimeve	Me miratimin nga Ministria e Mjedisit të Lejes së Mjedisit

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve (një faqe për çdo pikë të shkarkimeve)

Pikat e Shkarkimit:

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit: (numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit)	K 1
Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve	Brenda shesheve ku ndodhen depozitat e magazinimit të naftes dhe nenprodukteve të saj
Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit)	X:43 70 715.88 Y: 44 85 115.63
Emri i kompanisë e cila menaxhon sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura	A&T Sh.a
A është sistemi i kanalizimeve i lidhur me një impiant trajtimi?	Separatori i ndarjes së ujërave të ndotura me hidrokarbure Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane Vlore
Emri i mjedisit përfundimtar ujqor pritës të ujërave të ndotura nga rrjeti i kanalizimit (estuar, lumë ose mjedis tjetër ujqor pritës dhe ndikimi në të i cili duhet kontrolluar)	rrjeti i kanalizimeve të zones Ne asnjë rast nuk kemi shkarkime të drejteperdrejta në mjediset ujore sipërfaqesore, sepse ujqrat e sprucimit të depozitave (kryesisht gjatë stinës së thate) larges dhe sanitare me parë kalojnë në pusetat e dekantimit. Ujqrat e ftohjes së depozitave janë me cikël të mbyllur, ato përfundojnë në separatorin e ndarjes dhe riqarkullojnë perseri në proces, duke u depozituar në depozitën e ujqit.
Shenim: Nga zhvillimi i aktivitetit për shpërndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve të saj shkarkimet në kanalizime janë minimale. Në rrjetin e kanalizimeve të brendshme shkarkohen vetë ujqrat e sprucimit të depozitave gjatë stinës së thate dhe ujqrat e pastrimit të shesheve ku ndodhet depozitat e karburantit	

Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i shkarkimit	Nr. Ref. i pikës së shkarkimit	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Presioni akustik ¹ (dBA) duke ju referuar distancës
Depozita RMV-1	1	X: 43 70 804.69 Y: 44 85 067.86	65

- **KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;**

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj ndodhet në parkun e vjetër të F. I. E. T. K, Nartë – Vlorë, Zona Kadastrale 8605, Numer Pasurie 6/175, Vlorë.

• **Identifikimi i ndikimeve në mjedis dhe masat për minimizimin e tyre**

Mjedisi është gjithmone i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtperdrejtë, të terthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në teresi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në njërin prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti është i ndërtuar dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive të instalimeve për shpërndarjen dhe magazinimin e naftës dhe nënprodukteve të saj. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky projekt do të vazhdojë të jetë i tillë dhe pas shumë kohësh. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

Efektet e mundshme nga aktiviteti që ushtrohet do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme në këtë formular informues për pajisjen me leje mjedisi tipi B. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga nën-projektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

- **Impakti në mjedis i këtij impianti dhe menaxhimi i tij**

Në vijim do të paraqesim një përmbledhje të efekteve negative mbi mjedisin të cilat lidhen me operimin e punës në terminalin e shpërndarjes dhe magazinimit të naftës dhe nënprodukteve të saj të përdorur gjatë fazës operative së bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Ceshtjet e mjedisit të lidhura me fazat e shpërndarjes dhe magazinimit të karburanteve etj në llogjikën e ciklit të jetës së produktit përfshijnë:

- Praktikë e qëndrueshme: Impakti më i madh mjedisor si shpërndarja dhe magazinimi i karburanteve konsiston në menaxhimin e lëndës së parë duke maksimizuar përdorimin e lëndëve të para.

- Praktikë e qëndrueshme në menaxhimin e lëndës së parë gjatë magazinimit dhe përdorimit sa më eficient të saj, duke ripërdorur dhe ricikluar atë sasi të mbetjeve që gjenerohet si mbetje gjatë këtij procesi.

Praktikë e qëndrueshme në reduktimin e emetimeve në ajër nga procesi deozitimit të karburanteve,

Aspektet mjedisore më të rëndësishme që lidhen me shpërndarjen dhe magazinimin e naftës dhe nënprodukteve të saj kanë të bëjnë kryesisht me shkarkimet në ajër, trajtimin e ujërave dhe prodhimin e mbetjeve të ngurta.

- **Shkarkimet në ajër**

Nga proceset e shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj ne depoziten e karburantit, kemi gjenerimit te gazrave dhe avujve te demshem te cilat jane tipike per procese te tilla pune per ruajtjen e karburanteve. Gjithashtu te pranishme ne терминаlet e shkarkimit jane edhe aromat e naftes te cilat jane te pasmangshme edhe pse shoqeria ka marre masat e nevojshme per reduktimin ne maksimum te ketyre shkarkimeve.

- Shkarkime ne ujera

Nje ndikim tjeter i pranishem ne objektin ku zhvillohet aktiviteti eshte dhe menaxhimi i ujrave, Ujrat e gjeneruara nga proceset e pastrimit, larjes dhe sprucimit te depozitave gjate stines se thate, grumbullohen ne rrjetin e brendshme te kanalizimeve dhe perfundojne ne separatorin e ndarjes, ku behet e mundur ndarja e tyre nga hidrokarburet.

- Mbetjet e ngurta urbane dhe industriale

Mbetjet qe gjenerohen nga procesi i shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj dhe nga aktiviteti i perditshme i aktiviteti te punonjesve konsistojne ne gjenerimin e mbetjeve urbane nga punonjesit. Mbetjet urbane grumbullohen ne fraksione te ndara duke perdorur sistemin me tre kosha te 1-leter dhe karton, plastike dhe qelqe, 2-metale, kanace etj dhe 3- te thata dhe te kompostueshme. Ndersa mbetjet e gjeneruara nga proceset industriale grumbullohen dhe depozitohen ne depozita/fucia te padeptueshme deri e rikuperimin dhe asgjesimin perundimtar te tyre nga subjekte te licencuara.

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku janë të instaluar depozitat e karburantit
Biodiversiteti	

Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjate rruges që bëjnë të mundur hyrjen për në objekt.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve në ajër nga funksionimi i linjes së shpërndarjes dhe magazinimit të naftës dhe nenprodukteve të saj	Mirëmbajtja e linjes dhe reduktimi i shkarkimeve në ajër. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë këmbimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së depozitimit të karburanteve duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Sistemi i drenazhimit dhe separatori i ndarjes	
Sistemi i drenazhimit dhe separatori i ndarjes	Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujërave të shiut dhe ujërave teknologjike të pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaske dekantimi të përbashkët. Mirëmbajtje e separatorit të ndarjes së ujërave nga lëndet hidrokarbure, pastrimi periodik i tij.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve industrial dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në venddepozitimin më të afërt të caktuar nga njësi vendore. Asgjësimi i mbetjeve që vijnë nga instalimet, nga kompani të licencuara. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim në maksimum i mbetjeve të gjeneruar nga linja për shpërndarjen dhe magazinimin e naftës dhe nenproduktet e saj.
Ujërat e Ndotura Urbane	Përdorimi i ujit është me cikël të mbyllur, duke riqarkulluar të njëjten sasi uji për ftohje.. Maksimizimi i përdorimit të ujit.
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Ushtimi i operacioneve të shpërndarjes dhe magazinimit të naftës dhe nenprodukteve të saj brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjatë orareve të përshtatshme.

Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

- Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.
- Kompania ka ndertuar sistemin për riperdorimin e ujërave të ftohjes dhe krijimin e një cikli të mbyllur.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të këtu ndikime në ndryshimin e habitateve
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazan të vecantë. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Vendore për mbetjet urbane.
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.

Per me teper rekomandimet per te parandaluar dhe kontrolluar rrezikun e ndotjes perfshijme:

- Mbetjet urbane të grumbullohen transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara nga Njësia Vendore.
- Mbetjet teknologjike të grumbullohen dhe të ambalazhohen sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Të realizohet ndriçimi përreth terminaleve të depozitave.
- Të kryhet rregullimi i territorit në përputhje me kondicionet urbane të përcaktuara.
- Shoqëria të operojë në përputhje të plote me normat që janë në fuqi, dhe të kryej monitorime të vazhdueshme të tregueseve mjedisore të trysisë në mjedis.
- Të respektoje të gjitha rregullat e mbrojtjes kundër zjarrit gjatë operimit në objekt dhe të respektoje rregulloren e MKZ.
- Të instalohen dhe të respektohen sinjalistikat e trafikut të cilat do të minimizojnë impaktin për aksidente të mundshme.
- Për të minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, të limitohen proceset e zhurmshme gjatë orëve me të ndjeshme.
- Të respektoje të gjitha masat e përcaktuara në këtë Formular Kërkese të Lejes Mjedisore të Tipi B.
- Të respektoje të gjitha kushtet dhe masat që do të vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithatë perparësitë që ka ky aktivitet, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

- **ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;**

Shoqëria A&T Sh.a ka nënshkruar kontratën e nën-qirase me datë 19.01.2017 me shoqërinë "IONIAN REFINING AND TRADING COMPANY" Sh.a me Nr. 145 Rep, Nr. 53 Kol për marrjen me era të depozitës me kapacitet stokues 5 000 m³, me numër RMV-1 5000 m³ me vendndodhje në Parkun e Vjetër FIETK-Vlorë, Zona Kadastrale 8605, Numer Pasurie 6/175, instalim për të cilin është pajisur me Leje Mjedisit PN-3823-09-2016, datë 26.09.2016, Nr. Identifikimi 2377, Nr.6228Prot, për instalimin shërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj.

- **MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME);**

Plani i menaxhimit të mbetjeve

Aktiviteti që zhvillon shoqëria "A&T" Sh.a në **ne Parkun e Ri, FIETK-Vlorë, Zona Kadastrale 8605, Numer Pasurie 6/175, depozita RMV-1 Vlorë** nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt për shërndarjen dhe magazinimin e naftës dhe nënprodukteve të saj gjenerohet një sasi mbetjesh.

Rrymat prioritare të mbetjeve të gjeneruara në objekt dhe nga shërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, ndahen sipas fraksioneve të mëposhtme:

- Mbetje të rrezikshme me përmbajtje hidrokarbure nga pastrimi i depozitave dhe separatorit të ndarjes
- Mbetje të ngurta urbane (Mbetjet të ambalazhit, karton, plastik, kanaçe, etj)

Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve: Diferencimi i mbetjeve të gjeneruara brenda objektit të shfrytëzuar, sipas fraksioneve kryesore nëpërmjet instalimit të sistemit me 3-Kontenier, reduktimin e mbetjeve nga proceset e prodhimit, riciklimin dhe asgjесimin e mbetjeve dhe transportimi periodik të mbetjeve urbane në vendin e caktuar nga njësi vendore, përmes bashkëpunimit me NJQV-në, për firmat e kontraktuara në grumbullimin e mbetjeve urbane, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve të skrapit, në ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme në diferencimin e mbetjeve, duke maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal (ku kryhet dhe asgjесimi përfundimtar i tyre, sipas Strategjisë Kombëtare të Mjedisit për Menaxhimin e Mbetjeve).

Menaxhimi i mbetjeve brenda zonës së instalimit është tërësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Vlorë.

Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:

- Instalimi i sistemit me 3-kontenier brenda zones ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton dhe Mbetje të tjera).
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi ne maksimum te mbetjeve, duke rritur eficencen e vete linjes dhe reduktimin e koston per asgjesimin e tyre.
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitim e caktuar nga Njësia Vendore.
- Nëshkrimi i kontratave me biznesin e riciklimit për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane që gjenerohen nga aktiviteti
- Nenshkrimi i kontrateve me subjekte te licencuara er rikuperimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te parrezikshme dhe asgjesimin perfundimtar te tyre.

Synimet:

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e objektit dhe diferencimin e mbetjeve sipas tre rrymave kryesore.
- Organizimi i diferencuar i mbetjeve në përputhje me politikat kombëtare, për të mundësuar dhe stimuluar metodat e trajtimit të mbetjeve (riciklimi dhe riperdorim).
- Planifikimi dhe ngritja në nivelin zonal i një rrjeti të kontenierëve për diferencimin e mbetjeve me qëllim për të maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal
- Maksimizimi i përdorimit të mbetjeve urbane dhe mbetjeve teknologjike
- Maksimizimi per reduktimin e mbetjeve nga ushtrimi i aktivitetit per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe trajnimi i punonjësve të vetë shoqërisë, duke ofruar një eficient dhe efektivitet në diferencimin dhe menaxhimin të integruar të mbetjeve.
- Mbrojtjen e Mjedisit nga mbetjet e ndotura urbane dhe teknologjike duke maksimizuar dobinë e tyre dhe reduktimin e CO₂ në atmosferë.
- Asgjesimin perfundimtar dhe maksiminimin e perdorimit te mbetjeve.

Mbetjet e rrezikshme që gjenerohen nga operacionet e shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj do te rikuperohen ne depozita/fucia te padeptueshme dhe do te asgjesohen ne menyre perfundimtare nga subjekte te licencuara.

- **MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

Programi i Përmirësimit të Procesit të Punës

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO₂,

NOx, SOx në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë eficiente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti “**A&T Sh.a**”, me përfaqësues ligjor Z. Fabian Goçi ka hartuar “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme

Çfarë	Masat	Kush i zbaton
Parandalim	<ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë magazinimit, transportimit dhe përdorimit të teknologjisë. - Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme. - Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik. - Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis. - Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i depozitimit të karburanteve - Mbjajtja gjithmonë fikur e automjeteve gjatë procesit të ngarkimit dhe ruajtja e distancës së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit që punojnë në impiantin e depozitimit të karburanteve . - Mbjajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si : doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundër gazeve dhe pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen brenda objektit. - Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhesh të lubrifikantëve dhe grumbullimi i tyre në kontenier (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjësimit të tyre përfundimtar. - Grumbullimi, diferencimi dhe transportimi i mbetjeve industriale dhe të ngurta urbane çdo ditë në fund të procesit të punës në kontenierët e vendosur nga Njësia Vendore. - Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundër ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi. - Testimi paraprak i gjithë teknologjisë (instalimeve) dhe rrjetit elektrik. - Pastrimi periodik i vendit të depozitimit të lëndës së parë, pastrimi periodik i rrjetit të drenazimit të ujrave teknologjike të larjes dhe të shiut, sidhe mirëmbajtja e pemëve. - Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit dhe impiantit të instaluar. - Monitorimi periodik i parametrevë mjedisore dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë. 	Investitori, Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.

Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> - Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike - Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve. - Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti. - Vëzhgimi dhe kuludimi i vazhdueshëm i të gjithë teknologjisë dhe instalimeve të projektit. - Përdorimi eficient i energjisë elektrike si dhe sigurimi i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur për zhvillimin e aktivitetit. - Diferencimi i mbetjeve sipas rrymave specifike që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve në territorin brenda dhe jashtë objektit ku ndodhet instalimi. - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë. - Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash. - Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme. 	Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.
Ndërhyrje	<ul style="list-style-type: none"> - Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike - Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit. - Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti. - Kapja, asgjësimi i menjehershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjehershëm i ambientit të punës me detërgjente të posaçëm, që mund të gjenerohen nga linja e depozitimit të karburanteve dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim. - Zëvendësimi i menjehershëm të pjesëve të pajisjeve/aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme. - Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar. - Riparimi i menjehershëm i teknologjisë dhe linjës së shpërndarjes dhe magazinimit të naftës dhe nenprodukteve të saj, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve. - Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore. - Reduktimi i sasisë së ujrave të përdorura për qëllime sanitare, si dhe në rastet e kontaminimit me mbetje të rrezikshme izolimi i tyre në kontenier të posaçëm dhe të izoluar hermetikisht. 	Personeli dhe organet Shtetërore të Specializuara.

	<ul style="list-style-type: none"> - Kapja dhe trajtimi mjeksor i faunës së egër, njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme. - Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt. - Njoftimi i menjehershëm i automjeteve dhe njërive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj). - Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim. 	
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë, zones, instalimeve, infrastrukturës dhe mjeteve të përshkuara më sipër. 	

Raportimi i masa të ndërmarra për programin e përmirësimit të operimit

Raportimi i masave që do të ndërmerren në objektin ku ndodhet instalimi për shpërndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve të saj, F.I.E.T.K, Nartë-Vlorë, Zone Kadastrale 8605, Nr. Pasurie 6/175, depozita RMV-1, Vlorë, do të kryhet nga shoqëria **“A&T” Sh.a**, sipas një kalendari dhe regjistri të veçantë, i cili do të plotësohet nga drejtuesi teknik i punës në impiant dhe do të raportohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me miratimin e Përfaqësuesit Ligjor, Z. Fabian Goçi.

Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e shpërndarjes dhe magazinimit të karburanteve:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë decorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së depozitimit të karburanteve dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Mbetjet e rrezikshme me përmbajtje hidrokarbure të rikuperohen dhe asgjësohen nga subjekte të licencuara.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruara në këtë Formular-Kërkese për Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrfikëset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.

- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem si gjatë fazës së depozitimit të karburanteve të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike. Impiantet e nevojshme janë projektuar në përputhje me Ligjin e ri, nr.9379, datë 28-04-2005 “Për Eficencën Energjisë”, kjo do të çoj në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianti me eficencë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për shpërndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenproduktet e saj vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes se tokes qe disponon me qera.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Do të instalohet sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brëndshme gjatë periudhës Maj-Tetor.
- Linja e Impiantit të instaluar në objekt, do të koluaidohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficencës që kanë në kryerjen e operacioneve depozitimit të karburanteve
- Maksimizimi i përdorimit të lëndes se pare
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për

menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.

- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujit të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjedisëve të gjobëruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjëlbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.
- Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Zona ku do të realizohen operacioni i shërndarjes dhe magazinimit të naftës dhe nënprodukteve të saj është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarra të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundër zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së depozitimit të karburanteve.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Është ndërtuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në objektin e shërndarjes dhe magazinimit të naftës dhe nënprodukteve të saj.

- **MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për linjen e depozitimit të karburanteve është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar linja e depozitimit të karburanteve dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.

- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis.

Me qënë se kemi të bëjmë me instalime për shpërndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve të saj, i pozicionuar në Nartë, Vlorë nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në linjen e depozitimit të karburanteve, por dhe në një zonë mbi 150 m për rreth linjes.

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të impiantit të instaluar.
- Monitorimi i zonës së mundëshme të gjenerimit të gazrave gjatë aktivitetit të depozitimit
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve të gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorimi i mbetjeve të magazinuara dhe mbetjeve teknologjike të gjeruara nga instalimi
- Monitorimi i shkarkimit të ujërave të ndotura urbane që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i operimit të punës në objekt
- Monitorimi i sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka demtime merren masa për zëvendësime dhe fidanë të rinj. Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjellë do të vazhdojë për një periudhë 4 vjetecare, kohë gjatë së cilës bimët kanë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë më nevojë për shërbime.

Shkarkimet e rastit

Ndodhin kur lëndet ndotese leshohen në mjedis në mënyrë të paplanifikuar. Këto shkarkime ndodhin kur nuk ka pajisje për kontrollin e tyre. Si të tilla mund të jetë një shkarkim nga mosfunjionimi sic duhet i sistemit është një shkarkim afat shkruar dhe menjëher duhet të nderpritet puna për riparimin e difektit.

Shkarkimet aksidentale

Shkaktohen nga difektet në impiantet industriale, nga gabimet në manipulimin e pajisjeve. Këto shkarkime shkaktojnë ndotje shumë të larta, por ato ndodhin shumë rrallë.

Shkarkimet varen me shume nga menyra e punes se impiantit/instalimit, prandaj rezultati duhet te konsiderohet specifik per menyren e punes se burimit gjate marrjes se mostres.

Monitorimi i burimeve te shkarkimeve te lengeta

- Shkarkimet e lengeta mund te mos jene homogjene, ne kete rast duhet kujdes ne zgjedhjen e pikave te marrjes se mostres.
- Te njihet ecuria e procesit teknologjik
- Merren disa mostra pergjate seksionit terthor te tubacionit ose kanalit te shkarkimit
- Zgjidhet nje zone me perzierje te mire
- Depozitimi i lendeve te ngurta ndikon ne mostrat e marra prandaj largesia e pikes se marrjes se mostres te jete 25 fishi i diametrit te tubacionit te shkarkimit
- Nese nuk ka zona me homogjenitet te pershtatshem, mostrat te merren nga disa pika pergjate rrymes
- Kur perberja e mostrave ndryshon me kohen, merret nje seri mostrash ose nje perzierje e tyre.

Objektivi i vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis është të evidentojë vlerat reale të treguesve mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë në ajër, në ujëra të brendshme, në tokë, me qëllim që, në bazë të tyre, subjekti të ndërmarë masa dhe veprime korigjuese të përshtatëshme dhe të zbatueshme për zonën ku ushtron aktivitetin. Për rastet kur ka ndotje që ndikojnë në situatën e shëndetit publik dhe në mjedis, të përcaktojë shkallën e ndotjes dhe nivelin e devijimit nga normat e lejuar, në mënyrë që programi rehabilitues të hartohet i sakte dhe masat e ndërhyrjes të jenë ato të duhurat dhe në nivelin e duhur.

Në varësi të nivelit të zhvillimit të ndikimit mjedisor, masat që ndërmeren mund të përfshijnë ndalimin/eliminimin e shkakut të ndikimit, ose mund të jenë të karakterit zbutës e reduktues.

Zgjidhja më e mirë, kur rrethanat e lejojnë, është ndalimi/eliminimi i ndotjes dhe shkaqeve të tjera. Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis.

Subjekti merr përsipër sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu, do të ketë lidhje të vazhdueshme me Agjensinë Rajonale të Mjedisit Vlore, pranë të cilës do të informojë periodikisht për mbarvajtjen e punës si gjatë pdepozitimit te karburanteve ashtu dhe për monitorimin e parametrave të mësipër.

Monitorimi dhe rekomandime

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore.

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e

masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse.

Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si AKM-ja, ISHMP dhe Ministria e Mjedisit etj.

Në përputhje me karakteristikat e implementimit dhe të funksionimit të impiantit të shpërndarjes dhe magazinimit të naftës dhe nenprodukteve të saj dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente:

Monitorimi i parametrevë mjedisore

Nr.	Monitorimi	Parametrat që do të monitorohen	Vendodhja	Periudha kohore	Frekuenca	Përgjegjësia
1	Cilësia e Ajrit	NOx, SOx, CO, CO2	Depozita e karburantit	Nga fillimi i funksionimit 2017 e në vazhdim	Çdo 6 muaj	Shoqëria + Laborator i akredituar
2	Emetimi i zhurmave	Niveli i zhurmave në dB	Proceset e shpërndarjes dhe magazinimit	Nga fillimi i funksionimit 2017 e në vazhdim	Çdo 6 muaj	Shoqëria + Laborator i akredituar
3	Rastet, incidentet e mundshme në vendin e punës	Regjistrimi dhe raportimi i mënyrës së trajtimit	Instalimi Mjetet e transportit Magazinimi i lëndës së parë dhe transporti i produktit përfundimtar	Nga fillimi i funksionimit 2017 e në vazhdim	Çdo 6 muaj	Drejtuesi teknik
4	Avari apo defekte të ndryshme të mundshme gjatë operimit	Instalimet, makineritë,	Instalimi Mjetet e transportit	Nga fillimi i funksionimit 2017 e në vazhdim	Çdo 3 muaj	Drejtuesi teknik
5	Dëmtim i vegjetacionit apo të mbjellave	Pyjet, bimësia	Perimetri i objektit në shfrytëzim	Nga fillimi i funksionimit 2017 e në vazhdim	Çdo 6 muaj	Drejtuesi teknik + Punonjësit
6	Monitorim i zbatimit të kushteve të lejes mjedisore	Termetat e lejes mjedisore	Të gjitha pikat që përmenden në Lejen e Mjedisit	Nga fillimi i funksionimit 2017 e deri në rinovimin e lejes mjedisore	Në varësi të kushteve të Lejes Mjedisore	Laborator i Akredituar & ISHMP

f. KONSULTIMET NDERKUFITARE

Zona ku zhvillohet do te zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojte ti nenshtrohet procesit te konsultimit nderkufitar.

g. AUTORITETI VENDIMARRES PER DHENIEN E AKTIT TE MIRATIMIT TE LEJES SE MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QE NDIQEN.

Autoriteti miratues eshte Ministria e Mjedisit, Ministri i Mjedisit firmos per miratimin apo refuzimin e aplikimit per tu pajisur me leje mjedisit te tipi B, me propozim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacion e paraqitur nepermjet Qendres Kombetare te Biznesit.

Afati per marrjen ne shqyrtim te aplikimit per pajisjen me leje mjedisit te tipit B eshte 40 dite pune.

h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TE DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NE FORME ELEKTRONIKE, BRENTA 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.

Faqja zyrtare e Agjencise Kombetare te Mjedisit: akm.gov.al